

Pëmbledhje joteknik mbi dëgjesën e publikut të subjektit BESIM TETA PF për veprimtaritë ID 5.11 . Kompostim i mbetjeve bio. ID 5.10/b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart

Stacion grumbullimi, kompostimi (perpunimi) dhe konservimi të plehrave organike si dhe dërgimi për tregëtim brenda dhe jashtë vendit.

Qellimi I Aktivitetit:

Objekti i këtij aktiviteti është pastrimi i stallave të blegtorisë nga mbetjet organike të kafshëve përfshirë jashtëqitjet dhe materialet organike të shtesës, transportimi, grumbullimi në sheshin e ndërtuar për këtë qëllim, kompostimi (perpunimi), konservimi, si dhe dërgimi i plehrit organik në destinacionin e fermat bujqësore brenda dhe jashtë vendit.

Objekti i grumbullimit të mbetjeve organike do të jenë vetëm komplekset e stallave të gjedhit, delevë, dhive si dhe impiantet e mbareshtimit të pulave për mish dhe vezë.





Me subjektet qe do te jene te interesuar per pastrimin e ambienteve te tyre do lidhen kontrata sherbimi, ku do te percaktohen koha, sasia dhe menyra e pastrimit te tyre. Per grumbullimin dhe transportin e mbetjeve organike nga vendet e prodhimit te tyre deri ne stacionin e grumbullimit dhe te kompostimit do te perdoren mjetet e veta qe subjekti ka ne dispozicion.

Shesh grumbullimi i mbetjeve organike te stallave eshte pozicionuar ne zonen e Thumanes, ne krahun e majte te rruges dytesore qe lidh Fushe-Krujen me Thumanen ne nje siperfaqe prej rreth 2000m² me mundesi zgjerimi ne te ardhmen.



Perkufizimi I Lendes Organike:

Lënda organike i referohet substancave të përbëra nga komponime kimike që përmbajnë atome karboni, kjo është arsyeja pse kimia organike shpesh quhet "kimia e karbonit". Termi lëndë organike i referohet asaj që lidhet me jetën.: mbulon përbërësit që përbëjnë trupat e organizmave të gjallë, përveç shumicës së substancave dhe mbetjeve të tyre.

Në terminologjinë gjeologjike, lënda organike përfaqëson shtresën e sipërme të tokës, e cila përbëhet nga mbetjet e dekompozuar të organizmave të gjallë, duke përfshirë bimët, kafshët dhe mbeturinat, të cilat ofrojnë lëndë ushqyese thelbësore për organizmat prodhues si bimësia. Tokat që kanë përqendrimin më të lartë të lëndës organike njihen si më pjelloret.

Llojet e lëndës organike

Lënda organike në përgjithësi përbëhet nga:

- L proteinat Ato janë makromolekula të përbëra nga sekuenca lineare të aminoacideve, të cilat shfaqin veti të dallueshme fiziko-kimike që ndryshojnë sipas kompleksitetit të tyre.
- L lipidet Ato janë komponime të karakterizuara nga natyra e tyre hidrofobike, të cilat përfshijnë acide yndyrore, dyllëra, sterole, vitamina të tretshme në yndyrë, gliceride dhe fosfolipide. Funkcionet e tij përfshijnë ruajtjen e energjisë, sinjalizimin e qelizave dhe ndërtimin e membranave qelizore.
- Karbohidratet, të njohura edhe si sakaride, janë molekula të përbëra nga karboni, hidrogjeni dhe oksigjeni. Ato shërbejnë si entitete biologjike që sigurojnë një burim energjie.

Lëndët organike në tokë

Impakti I Lendes organike ne toke:

Roli pozitiv I lendes organike ne permiresimin e tokes si dhe ne rritjen e rendimenteve dhe cilesise se prodhimeve bujqesore mund te permbidhet si me poshte:

1. Lenda organike eshte burim I makro dhe mikroelementeve te domosdoshme per jeten e bimeve se N,P,K,Ca, Mg, S, Mo, Bo, Cu, Zn, Fe, Mn, etj.
2. Lenda organike rregullon strukturen e tokes
3. Lenda organike permireson kapacitetin ujembajtes se tokes,
4. Lenda organike redukton erozionin e tokes
5. Lenda organike permirezoon vetite kimike te tokes.
6. Lenda organike ka veti buferike dhe permireson pH e tokes.
7. Lenda organike shton bakteriet e dobishme ne toke
8. Lenda organike rrit temperature e tokes per mbjelljet e hershme.
9. Lenda organike rrit cilesine e prodhimeve dhe jetegjatesine e tyre pas vjeljes.
10. Lenda organike rrit ajrimin e tokes dhe si pasoje fuqizon systemin rrenjor te bimeve.



Anet negative:

Përdorimi i plehrave organike në rritjen e bimëve të ndryshme ka shumë përparësi, por ka edhe aspekte negative për përdorimin e tyre:

1. Përqendrimi i lëndëve ushqyese në tokë është i ulët.
2. Në plehra, sidomos në plehun organik, ka një numër të madh të barërave të këqija.
3. Plehurat organike dhe komplekse janë me kosto të lartë.

Metoda e kompostimit të plehut organik;

Aktiviteti I perpunimit të lëndës organike do të jetë në përputhje me standartet kombëtare dhe ato Europiane që sigurojnë cilësinë e produktit dhe mbrojnë mjedisin.

Për të arritur një produkt përfundimtar të certifikuar do të respektohet teknologjia e perpunimit natyral (aerobik) të lëndës organike e cila konsiston në:

Grumbullimin nga stallat vetëm i jashtëqitjeve kafsheve si dhe të shtresës organike e cila mund të jetë kashtë ose mbetje të kulturave bimë, kryesisht grurë, elb, tershere, theker, kashtë misri etj ose tallazh nga impiantete perpunimit të drurit të pastera nga mbetjet plastike, inerte etj.

Materiali organik do te vendoset ne grumbuj (kavaleta) te caktuara sipas llojeve dhe kohes se grumbullimit



Kontrolli I lageshtires se mases organike perben nje nga proceset kryesore per shpejtimin e procesit te kompostimit, Per kete arsye periodikisht cdo muaj ose dy muaj behet perzierja e mases per largimin e sasise se ujit te tepert ose ujitja e mases ne rastet kur lageshtia nuk eshte e mjaftueshme.



Përmbajtja e lagështisë ndikon në karakteristikat fiziologjike të mikrobeve dhe strukturën fizike të matricave të ngurta gjatë kompostimit të plehut të kafshëve. Nëse përmbajtja e lagështisë mbahet në një nivel të duhur, mikroorganizmat aerobik tregojnë konsum më aktiv të oksigjenit gjatë kompostimit për shkak të rritjes së aktivitetit mikrobik. Përmbajtja optimale e lagështisë është 50-70% te kapacitetit ujembajtes te mases organike.

Me një metodë të tillë në grumbullin e masës organike temperatura si pasojë e aktivitetit mikrobiologjik arrin në $t = 70^{\circ}\text{C}$. Procesi i dekompozimit zgjat rreth 4-5 muaj kur ka humbur deri në një të tretën e masës origjinale. Gjate procesit të dekompozimit ndodhin procese të shndërrimit të lëndës organike (Proteina, Yndyrna, Sheqerna) në elemente kimike të gatshme për bimët si N, P, K, Ca, Mg, S, Mo, Bo, Cu, Zn, Fe, Mn, etj., Avuj Uji H_2O , Dioksid Carboni CO_2 I nevojshëm për procesin e fotosintezës si dhe gaz Metan CH_4 shumë i përdorshëm në prodhimin e energjisë elektrike. Për prodhimin e energjisë nga gasi do të përqafitet një projekt në të ardhmen

Masa e dekompozuar (Plehu organik është i gatshëm për shitje pasi do të kryhen analiza Kimiko fizike në laboratore të certifikuar dhe pastaj do të jetë i gatshëm për shitje në fermat bujqësore.



Komposti eshte material organik qe mundte shtohet ne toke per ndihmuar bimet te rriten. Ky material thjesht pershpejton procesin duke siguruar nje mjedis ideal per bakteret, kerpudhat dhe organizmat e tjere te dekompozuar kjo lende quhet kompost. Instalimi i planifikuar eshte nje fushe kompostimi e hapur dhe e thjeshte per mbetjet bimore apo ato nga bagetite dhen, dhi dhe gjedh apo edhe pulari.

Ky instalim do te kete ne perberjen e tij (hapesiren)

- Zona per dorezim
- Sheshi i pritjes se volumeve te para
- Hapesirat e magazinimit (stacionimit te lendeve bio qe do te kompostohen)
- Hapesirat e magazinimit per kompostin e perfunduar
- Zona e perpunimi
- Zona e kompostimit per zhvillimin e gjithe procesit te kompostimit

BESIM TETA

Besim Teta

B. Teta